

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1014 Prot.

Tiranë, më 31.07 2017

VENDIM Nr. 144, datë 26.07.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, datë 26.07.2017, pasi shqyrtoi Projekt-propozim për ndryshimet e projektit të rehabilitimit "*Sheshit Publik para hyrjes së Portit të Durrësit*", paraqitur nga Bashkia Durrës.

VENDOSI:

1. Të miratojë Projekt-propozim për ndryshimet e projektit të rehabilitimit "*Sheshit Publik para hyrjes së Portit të Durrësit*", në lidhje me ruajtjen dhe integrimin e strukturave më përfaqësuese të zbuluara gjatë Gjurmimit Arkeologjik, realizuar nga Instituti i Arkeologjisë dhe DRKK Durrës.
2. Bashkia Durrës duhet të depozitojë pranë ASHA, projektin e zbatimit me ndryshimet për ruajtjen dhe integrimin e strukturave më përfaqësuese dhe detajimet përkatëse, sipas sugjerimeve të KKR, duke evidentuar gjurmën e gjurmimeve, të shoqëruar me itinerarin dhe tabelat shpjeguese.
3. Pa cënuar Vendimin "Për Sigurimin e Padisë" Nr.(00176) 922 Rregj. Dt. 7.2.2017 Regjistrimi me Nr. (82-2017-152)----Vendimi, Durrës 16.02.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Durrës, të realizohet monitorimi arkeologjik i punimeve të zbatimit të projektit nga DRKK Durrës, në vijim të akt-marrëveshjes Nr. 108 Prot., datë 27.01.2017.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO